

Tiparet gjuhësore të diskursit në orët e Edukatës Qytetare

Linguistic features of discourse in the classes of Citizenship Education

Disertacion i doktoratës

Abstrakti

Është shumë e qartë se kualiteti i sistemit arsimor të një vendi e përcakton në masë shumë të madhe kualitetin e jetës dhe mirëqenien shoqërore në të ardhmen. Duke pasur para sysh se gjuha ndërmjetëson të gjitha aktivitetet mësimore mund të thuhet se mënyra në të cilën prodhohet, plasohet dhe zhvillohet diskursi në procesin mësimor është hulumtuar shumë pak. Ky hulumtim synon të ndriçojë marrëdhënien ndërmjet diskursit i cili zhvillohet në orët mësimore të edukatës qytetare dhe zhvillimit të aftësisë së të menduarit kritik tek nxënësit.

Asimetria e moshës, diturisë, përvojës dhe autoritetit të nxënësve në raport me mësimdhënësit, por edhe me të gjitha autoritetet e sistemit arsimor duke filluar nga hartuesit e plan programit, tekstit mësimor e deri tek planifikuesit, strategët dhe drejtuesit qeveritarë të sistemit të arsimit, përcakton zhvillimin e një diskursi i cili është specifik në krahasim me diskursin në jetën në familje, në rrugë, në punë apo me diskursin publik të jetës shoqërore, politike apo kulturore. Hulumtimi përpiqet që të identifikojë disa karakteristika të këtij diskursi të cilat janë në marrëdhënie më të drejtpërdrejtë me zhvillimin a aftësisë së të menduarit kritik tek nxënësit.

Ndërtimi i kohezionit të diskursit me mjete akademike është i pamjaftueshëm nëse koherenca e diskursit në orët mësimore nuk ndërtohet në atë mënyrë që të lehtësojë të kuptuarit e marrëdhënies ndërmjet elementeve dhe parimeve kryesore të secilës njësi mësimore dhe të lëndës në tërësi. Kjo mund të arrihet më së miri nëpërmjet të zhvillimit të një dialogu të sinqertë me nxënësit, gjë të cilën mund ta bëjë vetëm një mësimdhënës i cili

nuk shkon në klasë me një autoritet të ndërtuar diku tjetër, dhe të përkrahur nga institucioni të cilit i përket, por autoritetin e ndërton pikërisht duke demonstruar afërsi dhe kujdes për nxënësit e jo duke i përdorur fuqitë të cilat i posedon falë asimetrisë së përmendur.

Dituria e paraqitur në tekstin mësimor duhet të shndërrohet në diskurs të përditshëm në orët mësimore, duke e negociuar jo vetëm kuptimin e përmbajtjeve mësimore por edhe pikëpamjet dhe vlerat, të cilat secili nxënës duhet t'i nxjerrë dhe t'i krijojë në mënyrë të pavarur, i nxitur prej këtyre përmbajtjeve. Përdorimi i strategjive diskursive të cilat e nxisin nxënësin për të arsyetuar përfundimet po edhe për të shqyrtuar mënyrën e vetë të të menduarit, i ndihmon ata që të pozicionohen në mënyrë kritike ndaj të gjitha informatave të cilat i marrin nga mësimdhënësi dhe nga teksti mësimor. Pozicionimi kritik gjithmonë nënkupton edhe pranimin dhe përqaftimin e informatave dhe vlerave të reja por edhe mos pranimin dhe refuzimin. Vetëm sistemi arsimor i cili i baraspeshon mundësitë për pranimin dhe mos pranimin e saktësisë apo vërtetësisë së informatave si dhe mundësitë për përqaftimin apo për refuzimin e vlerave të ndryshme mund të krijojë gjenerata të cilat do të kenë aftësinë e të menduarit kritik.

Fjalët kyçe: analiza e diskursit, të menduarit kritik, edukata qytetare, shoqërore, mësimdhënësi, nxënës, gjuhë, aftësi, dituri, argument, të mësuarit, të kuptuarit.

Abstract

It is beyond doubt that the quality of the educational system of a country determines to a great extent the life quality and the social welfare in the future. Whereas language facilitates all learning activities it can be said that the way the discourse is produced, launched and developed in the learning process has been researched very little. This research aims to elucidate the relationship between the discourse that is developed in the classes of citizenship education and critical thinking skills.

Asymmetry of age, knowledge, experience and authority of the students in relation to teachers, but also to all other educational system authorities ranging from the drafters of the curriculum, drafters of textbooks to the government planners, strategists and leaders of the educational system, determines development of a discourse which is specific compared to discourse in the family, on the street, at work or to the public discourse of the social, political or cultural life. The research tries to identify some features of this discourse which are in direct relationship with the critical thinking skills among students.

Construction of cohesion of the academic discourse with academic tools is insufficient if the coherence of the learning classes discourse is not constructed in the way that facilitates understanding of the relationship between main elements and principles of each lesson and of the subject in general. This can be best achieved through the development of a sincere dialogue with students, which can only be done by a teacher who does not go to class with an authority which is built elsewhere, and is supported by the institution to which he/she belongs, but builds his/her authority by demonstrating friendship and care for students and not by using powers which owns thanks to the mentioned asymmetry.

Knowledge presented in the textbook should be turned in daily discourse in classes, by negotiating not only the understanding of learning content but also the viewpoints and values which every student must draw and create independently and driven by these contents.

The use of discursive strategies which encourage the students to justify the conclusions but also to review their own way of thinking, helps them to position themselves critically to all the information that they receive from the teacher and the textbook. Critical positioning always means the acceptance and adoption of new information and values but also non acceptance and rejection. Only educational system which balances the opportunities for adoption and not acceptance of the accuracy or truthfulness of the information, as well as opportunities for embracing or rejecting the different values can create generations that will have the ability of critical thinking.

Keywords: discourse analysis, critical thinking, citizenship education, social, teacher, student, language, skill, knowledge, argument, learning, understanding.